



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

RAPORTI I MONITORIMIT 12-MUJORI I 2018

MIRATOI

Lorin YMERI

Drejtor Ekzekutiv

JANAR 2019
ADISA

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje	3
II.	Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.....	3
	A. Treguesit e performancës ne nivel qëllimi.....	4
	B. Treguesit e performancës në nivel objektiv.....	4
III.	Buxheti i miratuar dhe faktik për 12 mujorin e 2018.....	7

I. Hyrje

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është person juridik publik, i organizuar në formën e agjencisë autonome të krijuar me Ligjin nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 109, datë 30.11. 2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe mbështetur në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” po Ju paraqesim raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2018.

Në realizimin e këtij raporti Ekipi i Menaxhimit të Programit ka bërë monitorimin e vazhdueshëm nëpërmjet procesit të vlerësimit dhe krahasimit të treguesve faktik të performancës me ata të planifikuar. Ky raport në vijim është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Qëllimi i këtij monitorimi ishte ndjekja e vazhdueshme e arritjes së objektivave të synuar të përcaktuar tashmë në deklaratën e programit “Transformimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri përmes qasjes me në qendër qytetarin duke realizuar ndarjen funksionale dhe integrimin e shërbimeve publike në sportel, zhvillimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve, marrjen e opinioneve të qytetarëve dhe monitorimin e lëvrimit të shërbimeve të standardizuara.”

Në përfundim të këtij raporti, informacioni i marrë shërbeu për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit për periudhën në vijim. Ekipi i Menaxhimit të Programit monitorimin e objektivave e ka bërë bazuar në treguesit e performancës, në sasi dhe vlerë për produktet, si një proces që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse.

Në vijim të këtij raporti do të gjeni një informacion të hollësishëm, të problematikave, mangësive të vërejtura, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës, realizimin e produkteve krahasuar me planin në terma sasiorë dhe cilësorë shoqëruar me argumentet përkatës, konkluzionet si dhe propozimet konkrete për periudhën në vijim në lidhje me ndryshimet për rishikimin apo jo të politikës së programit apo propozime të tjera për përmirësimin e situatës.

II. Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën: **“Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike”** ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2018, i ndarë sipas artikujve ekonomikë.

Nëpërmjet këtij programi synohet konsolidimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve publike të integruara ndaj publikut në mënyrë të drejtë për drejtë, nëpërmjet sporteve në Qendrat e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të shërbimeve në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi të lartë.

Për matjen e performancës së programit nga Ekipi i Menaxhimit të Programit janë evidentuar dhe matur treguesit në nivel qëllimi dhe treguesit në nivel objektiv, si me poshtë vijon:

A. Treguesit e performancës në nivel qëllimi

1. Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike;
2. Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportet ADISA;

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	Plan	Fakt	% Realizimit
Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike	343/1300	367/1300	107%
Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportet ADISA	60%	90%	150%

B. Treguesit e performancës në nivel objektiv

1. Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike;
2. Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike;

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Objektiv	Plan	Fakt	% realizimit
Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike	581/1300	891/1300	153%
Numri i shërbimeve publike që mbulohen me formularë aplikimi të	460/1300	608/1300	132%

standartizuar mbi numrin total të shërbimeve publike			
--	--	--	--

Më poshtë po Ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të vendosura nga ana jonë, si më poshtë:

- **Treguesi A.1 - Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike.**

Për vitin 2018 ka filluar puna për marrjen dhe ofrimin e shërbimeve edhe për institucione të tjera duke synuar ofrimin e sa më shumë shërbimeve në një Qendër të vetme. Ky proces ka nisur në muajin Shkurt 2018 me vlerësimin e përshtatshmërisë së shërbimeve respektive për t'u integruar në sportelet ADISA, proces i cili do të vijojë deri në Dhjetor 2018 me hartimin e propozimeve ligjore/nënligjore dhe përgatitjeve të tjera të rastit për përshtatjen e sporteleve pranë Qendrave të Integruara ADISA për këtë qëllim.

Kalimi i këtyre shërbimeve për tu ofruar në sportelet e ADISA do të rezultonte në:

- Marrjen e shërbimeve në sportele lehtësisht të arritshme dhe të aksesueshme nga përfituesit e shërbimit;
- Reduktimin e kohës për përfituesit e shërbimeve pasi propozohet zhvendosja e sporteleve nga një zonë periferike në një zonë lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë përfituesit (rasti i shërbimeve që ofrohen pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë);
- Kalimi dhe ofrimi i këtyre shërbimeve jo vetëm në sportelet e ADISA Tiranë por edhe në Qendrat e Integruara Fier, Gjirokastrë, Kavajë dhe Krujë e më tej në Qendrat e tjera në plan për tu hapur nga ADISA.

Gjatë kësaj periudhe ofrimi i shërbimeve të ALUIGN -it janë pilotuar në Qendrën e Integruar Fier ku janë vendosur në dispozicion 2 sportele. Në vijim të kalimit dhe ofrimit të shërbimeve të ALUIGNIT pranë sporteleve të shërbimit ADISA, është dakordësuar angazhimi dhe trajnimi i stafit në sportelet e shërbimit të ALUIGNIT. Me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm mbi ëork - floë e ofrimit të shërbimit si dhe evidentimin e problematikave eventuale për secilën Qendër është caktuar nga një punonjës (në total 5). Njohuritë e marra do të përcillen me pjesën tjetër të stafit të sporteleve ADISA ndërsa problematikat do të raportohen në Drejtorinë e Përgjithshme të cilat më pas do të shqyrtohen dhe bashkarisht me përfaqësuesit e ALUIGNIT do të punohet për zgjidhjen e tyre.

I njëjti skenar do të zbatohet edhe për Institucionet e tjera në Qendrat ekzistuese e më tej në Qendrat e tjera në plan për tu hapur nga ADISA.

Gjithashtu gjatë vitit 2018 në fokus, janë përfshirë shërbimet e institucioneve si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Për këtë institucion është propozuar transferimi i një kategorie të caktuar shërbimesh të DPSHTRR (pajisje me certifikate aftësie profesionale, rinovime dëshmi për shërbime taksi si dhe shërbimet të cilat lidhen me Regjistrimin e Kandidatëve, për herë të parë dhe shtesë kategorie) në Qendrat e Integruara ADISA, shërbime këto për përfitimin e të cilave qytetari paraqitet dy herë pranë DRSHTRR (një herë në momentin e aplikimit dhe për së dyti në momentin e pajisjes me dokumentin e kërkuar).

- **Treguesi A.2- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ADISA.**

Ky objektivi është realizuar në masën 100%. Gjatë vitit 2018 janë realizuar sondazhe me anë të instrumenteve të ndryshme për matjen e kënaqësisë së qytetarëve me mënyrën e ofrimit të shërbimeve në Qendrat e Integruara ADISA, nga ku rezulton se 90% e të anketuarëve shprehën shumë të kënaqur me mënyrën e përfitimit të shërbimeve publike në sportelet ADISA (veçanërisht me trajtimin në sportel, kushtet e akomodimit dhe menaxhimin e radhës).

- **Treguesi B.1 – Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike.**

Gjatë vitit 2018, është punuar me 43 institucione, duke plotësuar platformën (IPSD) e dizenuar për inventarizimin e shërbimeve publike. Duke qenë se platforma IPSD u krijua në 2018, si pasojë edhe kartelat ekzistuese janë hartuar nga e para. Nga 43 institucione, 26 ishin institucione me të cilat nuk kemi pasur bashkëpunim. Numri i kartelave informative të hartuara për herë të parë është 406, ndërsa në total numri i kartelave informative të punuara është 891.

- **Treguesi B.2 – Numri i shërbimeve publike që mbulojnë me formularë aplikimi të standardizuar mbi numrin total të shërbimeve publike.**

Gjatë vitit 2018 janë standardizuar 180 formularë të rinj për 17 institucione që mbulojnë 374 shërbime publike. Gjithashtu janë përditësuar 72 formularë ekzistues. Në total numri i formularëve të aplikimit të standardizuar është 293 për 24 institucione dhe mbulojnë në total 608 shërbime publike.

III. Buxheti i miratuar dhe faktik për 12 mujorin e 2018

000/lekë

Buxheti 2018	Plan	Fakt	% realizimit
Paga	102,780	96,226.7	94%
Sigurime Shoqërore	21,490	15,939.5	74%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	25,000	24,693.2	99%
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	53,595	38,925.6	73%
Shpenzime Kapitale me financim të huaj	150,000	62,620.5	55%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës të miratuar me VKM nr. 306 datë 05.04.2017 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”. Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 96 227 mijë lekë për artikullin 600 dhe 15 940 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në 90 % të totalit të buxhetuar. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktit së të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive.

Numri faktik i punonjësve të punësuar në fund të muajit Dhjetor 2018 është 144 persona. Brenda këtij numri janë përfshirë dhe 4 punonjëse me leje lindje të cilat marrin pagesë nga sigurimet shoqërore. Gjatë vitit 2018 janë punësuar si personel me kohë të plotë 18 punonjës. Të larguar nga puna gjatë kësaj periudhe kanë qenë 12 punonjës.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 24 926 mijë lekë ose 99% të totalit. Kjo masë realizimi konsiderohet si realizim shumë i mirë. Fondi i realizuar përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje, “Dietat brenda vendit”, “Shpenzime energji elektrike”, “Shërbim roje private”, “Shërbim postar”, “Shërbim telefoni”, “Shërbim mirëmbajtje automjeti”, “Siguracion automjeti”, “Shërbim mirëmbajtje ashensori”, shpenzime për ujësjellës kanalizime”, “Taksa bashkie”, “FV Pjesë këmbimi për fotokopje dhe printer”, “Riparim i dyerve, dritareve dhe vetratave” “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, etj.

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar:

1. Mbështetje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin (TVSH) 26 477 730 lekë, realizuar në masën 25 076 mijë lekë ose 94%.
2. Blerje pajisje TIK në shumën 6 360 mijë lekë, realizuar në masën 5 609 mije lekë ose 88%. Numri total i pajisjeve të blera në vitin 2018 është 89 copë.
3. Blerje shkallë dyshe, fshesë me korrent në shumën 204 mije leke, realizuar në masën 199.6 mije lekë ose 97%.
4. Blerje pajisje TIK, detyrim i vitit 2017 në shumën 1 792 260 lekë, realizuar në masën 100%.
5. Blerje pajisje dhe sistem kontrolli i aksesit në shumën 294 000 lekë, realizuar në masën 100%
6. Blerje kamera për përmirësimin e sistemit në sportel në shumën 96 000, realizuar në masën 100%.
7. Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Shkodër, kontraktuar në vlerën 45 371 493 lekë dhe likuiduar në vlerën 5 865 606 ose 12% e kontratës. Për vitin 2018 fondi i detajuar për këtë projekt është 18 371 mijë lekë. Realizimi i kontratës ndaj fondit të planifikuar për 2018 është në masën 31%.

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është miratuar në shumën 80,000 mijë lekë në zërin 230 dhe 70,000 mijë lekë në zërin 231 dhe është rishikuar gjatë vitit duke shkuar në vlerën 110,000 mije lekë. Financimi i huaj është i detajuar sipas regjistrimit të prokurimeve të miratuar nga Banka Botërore Nga ky fond janë realizuar në masën 54,414 mijë ose 136% artikulli 230 dhe artikulli 231 në shumën 6,207 mije leke ose 9%. Në total fondi i investimeve të huaja është realizuar në vlerën 60,621 mijë lekë ose 55% e fondit total.